



Keshilli i Bashkisë Korçë

Komisioni i Mirëqënies Sociale, Strehimit, Rinisë, Barazisë Gjinore

RAPORT VENDIMARRJE

Nr.____ datë 28/07/2025

Nr.____ Prot

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë

Lenda: Vendim për shqyrtimin e projekt vendimeve, relacioneve dhe dokumentave shoqërues, në lidhje me propozimet:

- 1. (pika 4 e rendit të ditës) “MBI DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE NGA 6 % E FONDIT TË KUSHTËZUAR PËR BLOK-NDIHMËN EKONOMIKE DHE NGA FONDI I BUXHETIT VENDOR, PËR PERIUdhËN 1-30 QERSHOR 2025**

Analiza ligjore: (bazueshmëria ligjore e propozimit të projekt-vendimit dhe e vendimit të Komisionit të Përhershëm – a është i mbështetur në ligj propozimi dhe vendimarrja)

Ligjin nr.139, datë 17.12.2015, "Perveteqeverisjen vendore", Ligjin nr.9936 dt.26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" I ndryshuar, në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9 pika 1, nenpika 1.1, shkronjat "a" dhe "b", nenit 24, nenit 55, pikat 2 dhe 6. Ligjit nr.115/2024 "Për buxhetin e vitit 2025". VKB Nr.176, datë 26.12.2024, "Mbi Miratimin e Buxhetit vjetor të vitit 2025 dhe PBA 2025-2027 të Bashkisë Korçë", udhëzimin plotësues Nr.2, datë 24.01.2025, për zbatimin e buxhetit të vitit 2025. Ligjit nr.57/2019 "Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë", në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozim të Këshillit të Ministrave, të V.K.M Nr.597, datë 04.09.2019, "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të Ndihmës Ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtezuar për ndihmën ekonomike" i ndryshuar, në mbështetje të nenit 100 të kushtetutës, të neneve 12, pikat 1,4,5, 16, pika 2 dhe 21 të ligjit nr 57/2019 "Për asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë", të Udhëzimeve m. 3, 4, 5, pika 2, datë 17.02.2017 të Ministrisë të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Vendimit nr. 4 dhe nr. 5, datë 30.01.2025 të Këshillit Bashkiak Korçë, **"Për miratimin e kriterëve për familjet në nevojë që dote trajtohen me ndihmë ekonomike, deri në 6% të fondit të kushtezuar për bllok-ndihmën ekonomike" dhe nga fondi i buxhetit vendor të Bashkisë**

Situata aktuale e funksionit (përshkrim i situatës së shërbimit / funksionit – nëse konstatohet që ekziston nevojë për këtë vendim të propozuar dhe çfarë problematike zgjidh ai)

Projekt vendimet e paraqitura janë periodike në bazë të procedurave dhe dokumentacionet që plotësojnë banorët.

Situata financiare : (Shtesa / pakësime në buxhet – a ka efekte në buxhet dhe a është parashikuar ap nevojitet buxhet shtesë për zbatimin e vendimit)

Fondi prej 6% është i parashikuar prej fillimit të vitit dhe është pjesë e buxhetit të Bashkisë.

Drejtoria / Sektori përgjegjës (kush është sektori apo drejtoria që do të ngarkohet me zbatimin)
Drejtoria e Kujdesit Social dhe Drejtoria e Finances, Buxhetit dhe MFK

Monitorimi dhe raportimi : (kush monitoron zbatimin, raporton dhe sa shpesh)
Drejtoria e Kujdesit Social dhe Drejtoria e Finances, Buxhetit dhe MFK. Raportimi në raportin e buxhetit 2025

Impakti social / grupet që preken: (a ka efekte sociale, pozitive apo negative, grupet që preken dhe impakti që sjell vendimi)
Përfitojnë familjet në vështirësi ekonomike të cilat për shkaqe të ndryshme nuk kanë përfituar nga sistemi i pikëzimit. Procedurë ligjore e përmujashme.

A është objekt i konsultimit publik: (A është projekt-vendimi subjekt i konsultimit publik në zbatim të Ligjit 139/2015 ?)
Jo

Komisioni i Përhershëm për **Mirëqënien Sociale, Strehimit, Rinisë, Barazisë Gjinore**, i mbledhur me datën 23/06/2025, shqyrtoi projekt vendimet, relacionet dhe dokumentat shoqërues në lidhje me propozimet për:

- 1. (pika 4 e rendit të ditës)** “MBI DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE NGA 6% E FONDIT TË KUSHTËZUAR PËR BLLOK-NDIHMËN EKONOMIKE, DHE NGA FONDI I BUXHETIT VENDOR, PËR PERIUDHËN 1 – 30 QERSHOR 2025”.

Pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese,
Komisioni me shumicë votash,

VENDOSI

- 1.** T'i propozojë Këshillit Bashkiak miratimin e projektaktit

Bashkëlidhur **argumentat e vendimmarrjes** i paraqitur në procesverbalin e mbledhjes së Komisionit

Kryetar i Komisionit

Sekretar i Komisionit

Datë 28/07/2025